

Radicalisation Awareness Network



VVT

*Working group voice of
victims of terrorism*

Manual: Zërat e viktimave të terrorizmit

Colofon

Ky manual është një përmbledhje e përvojave të shkëmbyera gjatë takimeve të Grupit të Punës për Zërat e Viktimave të Terrorizmit (RAN VVT), të zhvilluara nga viti 2012 deri në vitin 2015. Të gjitha viktimat, organizatat e viktimave, specialistët dhe ekspertët e pranishëm në këto takime kanë dhënë kontributin e tyre në këtë manual.

Autorët

Guillaume Denoix de Saint Marc, kryetar i Grupit të Punës RAN

VVT, Luca Guglielminetti, kryetar i Grupit të Punës RAN VVT

Josée Netten, »Foundation Impact«/«Arq Psychotrauma Expert Group» Stéphane Lacombe, AfVT

Maarten van de Donk, Sekretariati i

RAN Jerry Galesloot, Sekretariati i RAN

Pomme Woltman, Sekretariati i RAN

Rekomandimet e Grupit të Punës RAN VVT

Ky manual është një përmbledhje e përvojave të shkëmbyera gjatë takimeve të Grupit të Punës për Zërat e Viktimave të Terrorizmit të Rrjetit për Ndërgjegjësimin kundër Radikalizmit (RAN VVT), të zhvilluara nga viti 2012 deri në vitin 2015. Grupi i punës RAN VVT mori në konsideratë mënyrën sesi dëshmitë e viktimave të terrorizmit mund të shërbejnë si një rrëfim i fuqishëm në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Ky manual synon të shpërndajë përvojat e shkëmbyera me personat e angazhuar në mbështetjen e viktimave. Krahas organizatave të viktimave, ai synon t'i drejtohet një audience edhe më të gjerë: edukatorëve, personave që punojnë me të rinjtë dhe profesionistëve të tjerë që kontribuojnë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (p.sh. personeli i burgjeve/i shërbimit të provës apo policia komunitare).

Ky manual ofron gjithashtu rekomandime për mbështetjen e proceseve të vendimmarrjes. Është bërë një dallim ndërmjet rekomandimeve të dhëna për organizatat e viktimave, atyre për shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE-së) dhe atyre për Komisionin Evropian. Ky manual nuk ka për synim të jetë gjithëpërfshirës, por të sigurojë një kuadër për personat që marrin dëshmitë e viktimave të terrorizmit.

Organizatave të viktimave

- Kujdesuni për individët viktimë. Objektivi kryesor është dhënia e ndihmës për viktimat në mënyrë që ato të rifitojnë pavarësinë dhe vendin e tyre në shoqëri, dhe këshillimi i tyre me qëllim që ato të përballen me tragjedinë që u ka ndodhur. Viktimave që dëshirojnë të luajnë një rol aktiv në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm u duhet dhënë mbështetja e duhur përpara, gjatë dhe pas dhënies së dëshmisë së tyre. Për viktimat nevojitet gjithashtu mbështetje profesionale, si për shembull nëpërmjet psikologëve, rrëfimtarrëve apo ekspertëve pedagogjikë.
- Viktimat e terrorizmit janë ambasadorët e kujtesës kolektive. Mbledhja, dokumentimi dhe shpërndarja e dëshmimeve të tyre do të skalisë në kujtesë sulmet terroriste dhe viktimat e tyre - për të mos u harruar kurrë nga brezat e tashëm dhe të ardhshëm.
- Organizatat e viktimave duhet të jenë (më) të vetëdijshme mbi rolin e mundshëm që ato mund të luajnë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Organizatat duhet të përfshijnë njerëz të cilët janë të gatshëm të dalin në mbrojtje të vlerave demokratike. Vizioni dhe kapaciteti i viktimave duhet të zgjerohet brenda mundësive: gama e gjerë e profileve të viktimave do të rrisë mundësitë e zgjedhjes së përcjellësve të besueshëm të mesazhit në situata të ndryshme dhe te grupe të ndryshme të synuara (shkolla, burgje, institucione që punojnë me të rinjtë, etj.).
- Organizatat e viktimave brenda BE-së dhe jashtë saj duhet të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë praktikat më të mira, me synimin për të përforcuar dhe përmirësuar përdorimin e dëshmimeve.
- Për të qenë më efektive, dëshmitë duhet të përdoren në kuadrin e një programi më të gjerë dhe mund të lidhen me çështje të tjera, të tilla si edukimi qytetar, historia dhe të menduarit

kritik. Është mirë që dëshmia të nisë nga një perspektivë e përgjithshme demokratike, dhe të shprehë vlerat demokratike. Është e rëndësishme që në dëshmi të përfshihet koncepti i trajtimit çnjerëzor, dhe të shprehet qartë fakti se jo të gjithë autorët frymëzohen nga të njëjtat ideologji. Për shembull, sulmet ekstremiste me motive fetare mund t'i shtyjnë njerëzit të mendojnë se të gjithë autorët e terrorizmit i përkasin fesë myslimane.

- Organizatat e viktimave duhet të caktojnë një person përgjegjës brenda organizatës së tyre për publikimet në internet dhe në media sociale. Ky person duhet të ketë aftësitë dhe mjetet e duhura për të transmetuar rrëfimet dhe mesazhet e viktimave online. Ai duhet të trajnohet për kryerjen me efektivitet të këtyre detyrave.
- Duhet pasur vazhdimisht parasysh fakti se nuk duhet të ekzistojë koncepti i »hierarkisë« së viktimave, apo i hierarkisë së vuajtjeve të tyre. Çdo viktimë meriton mirëkuptim, njohje dhe mbështetje.
- Siguria e viktimave duhet të garantohet në çdo kohë.
- Vlerësimi strukturor dhe profesional i metodologjisë së programeve të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm është çelësi drejt përmirësimit të përdorimit të dëshmimeve në kuadër të kësaj lufte.

Shtetet anëtare

- Për viktimat e terrorizmit, njohja dhe pranimi i të drejtave të tyre është me rëndësi jetike, si për mirëqenien e tyre personale ashtu edhe për rolin e tyre të mundshëm si kontribuues të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit ndaj radikalizmit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm. Njohja dhe pranimi i viktimave të terrorizmit me ligj dhe në praktikë është një faktor kyç.
- Shtetet anëtare duhet të përfshijnë viktimat e terrorizmit në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm.
- Organizatave të viktimave duhet t'u sigurohet njohje dhe lehtësira. Shtetet anëtare mund të nxisin kohezionin social mes qytetarëve dhe viktimave duke lehtësuar ngritjen e shoqatave të viktimave të terrorizmit. Edhe pse pavarësia e organizatave është me rëndësi madhore, organizatat e viktimave mund të përfitojnë mbështetjen e qeverive. Kjo mbështetje mund të përfshijë trajnime mbi përdorimin e internetit dhe mediave sociale, apo lehtësimin e aksesit të tyre në sistemin arsimor. Kjo mbështetje mund të ofrohet gjithashtu nëpërmjet nxitjes së bashkëpunimit dhe angazhimit mes organizatave të ndryshme lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare që trajtojnë çështje të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm, si dhe nëpërmjet sigurimit të infrastrukturës dhe burimeve (njerëzore) të nevojshme. Të gjitha viktimat e terrorizmit dhe organizatat për mbështetjen e tyre duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, pa asnjë lloj diskriminimi.
- Mesazhi i dhënë nga organizatat e viktimave duhet të gjejë mbështetje. Organizatave të viktimave duhet t'u sigurohet akses në shërbimet e komunikimit publik (siç janë rrjetet kombëtare të transmetimit) dhe duhet t'u ofrohet mbështetje për projektet dhe aktivitetet



e tyre të komunikimit. Në këtë pikë, ndihma për komunikimin është tejet e nevojshme. Si organizata të vogla joqeveritare (OJQ), dhe në shumicën e rasteve pa asnjë mbështetje specifike profesionale, organizatat për mbështetjen e viktimave të terrorizmit përballen shpeshherë me vështirësi në tërheqjen e vëmendjes së mediave, kryesisht në rastet kur ato konkurrojnë me zërat e organizatave me burime të shumta financiare dhe njerëzore, të cilat dëshirojnë të influencojnë opinionin publik.

Komisioni Evropian

- BE-ja duhet të njohë dhe mbështesë pjesëmarrjen e viktimave dhe organizatave të viktimave në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (në politikat lidhur me këtë luftë). Ekziston nevoja për një ndërgjegjësim të përgjithshëm në nivel BE-je për harmonizimin e politikave të shteteve anëtare për mbështetjen e viktimave të terrorizmit.
- Thirrjet e BE-së për tender në kuadër të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm duhet të nxisin përfshirjen e viktimave dhe të organizatave të viktimave. Ato duhet të jenë më fleksibël dhe më të hapura ndaj organizatave më të vogla që dëshirojnë të aplikojnë.
- Duhet të sigurohet njohje dhe mbështetje për ngjarjet përkujtimore në mënyrë që të fuqizohet kujtesa kolektive, kohezioni social dhe vlerat demokratike. Ky duhet të përbëjë një prej parimeve të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm për Evropën. Për shembull, Dita Evropiane e Përkujtimit mund të organizohet ndryshe: ajo mund të jetë më publike dhe më e hapur ndaj mediave, të përfshijë shoqërinë civile (edukatorët, të rinjtë, etj.), më shumë zyrtarë të qeverive kombëtare dhe anëtarë të Parlamentit Evropian. Gjithashtu, shteteve anëtare mund t'u rekomandohet organizimi, formalizimi dhe zyrtarizimi i një dite kombëtare të përkujtesës, në bashkëpunim me organizatat e viktimave.

Tabela e përmbajtjes

Kapitulli 1: Hyrje	7
1.1 Viktimat dhe organizatat e viktimave si kontribuuese në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm	7
1.2 Synimi i këtij manuali	8
1.3 Struktura	9
Kapitulli 2: Situata e viktimave të terrorizmit dhe organizatave të viktimave	9
2.1 Konteksti	9
2.2 Njohuri të rëndësishme	11
2.3 Përgatitja e viktimave për dhënien e dëshmisë së tyre	14
Kapitulli 3: Dëshmitë e viktimave të terrorizmit	15
3.1 Faktorët që ndikojnë në procesin e komunikimit	15
3.2 Efekti i dëshmime	16
3.3 Dëshmitë e drejtpërdrejta	16
3.4 Dëshmitë e tërthorta (fotografi/filma/dokumente)	17
3.5 Udhëzime për përdorimin e dëshmime	18
3.6 Interneti dhe media sociale	20
Kapitulli 4: Bashkëpunimi me median	22
4.1 Përmbajtja	23
4.2 Forma	24
4.3 Përgatitja	25
4.4 Marrëdhëniet me median	26
Kapitulli 5: Bashkëpunimi me ish-ekstremistët	27
5.1 Fuqia e dy anëve të monedhës	28
5.2 Kushtet paraprake për bashkëpunim	28

Kapitulli 1: Hyrje

1.1 Viktimat dhe organizatat e viktimave si kontribuuese në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm

Viktimat e terrorizmit: përkufizimi

Në të drejtën ndërkombëtare nuk ka asnjë përkufizim të përcaktuar qartë për termin »viktimë e një akti terrorist«.

Megjithatë, një përkufizim i termit »viktimë« është dhënë në nenin 1 të Deklaratës së Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi Parimet Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimin dhe Keqpërdorimit të Pushtetit (referuar në vijim si Deklarata e OKB-së e vitit 1985):

1. »Viktimat« janë persona të cilët kanë pësuar individualisht apo kolektivisht një dëmtim në formën e lëndimit fizik apo mendor, vuajtjes psikologjike, humbjes ekonomike apo kufizimit thelbësor të të drejtave të tyre, nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të kryera në shkelje të legjislacioneve penale të zbatueshme në shtetet anëtare, duke përfshirë ligjet që parashikojnë krimin e keqpërdorimit të pushtetit.
2. Një person mund të konsiderohet si viktimë në kuptimin e kësaj deklaratë pavarësisht faktit nëse autori është identifikuar, kapur, ndjekur penalisht apo dënuar, dhe pavarësisht marrëdhënies familjare ndërmjet autorit dhe viktimës. Termi »viktimë« përfshin gjithashtu, sipas rastit, familjarët e afërt apo personat në varësi të viktimës së drejtpërdrejtë dhe personat të cilët kanë pësuar dëm gjatë ndërhyrjes në ndihmë të viktimave në nevojë apo me qëllimin për të parandaluar viktimizimin.
3. Dispozitat e këtij neni duhet të zbatohen njësoj për të gjithë, pa asnjë lloj dallimi me bazë racën, ngjyrën, gjininë, moshën, gjuhën, fenë, kombësinë, pikëpamjet politike apo pikëpamjet e tjera, besimet apo praktikat kulturore, pronësinë, lindjen ose statusin familjar, etninë apo origjinën sociale, dhe aftësinë e kufizuar.

Gjithashtu, sipas Rekomandimit 2006(8) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për ndihmën e ofruar nga shtetet anëtare ndaj viktimave të krimin, »termi »viktimë« përfshin gjithashtu, sipas rastit familjarët e afërt apo personat në varësi të viktimës së drejtpërdrejtë«.

Viktimat e terrorizmit kanë një përvojë të përbashkët: ata ndajnë të njëjtat ndjenja dhe vuajtje personale pas një sulmi terrorist. Megjithatë, ka edhe rrethana të ndryshme. Për shembull, disa viktima ndodhen nën kërcënimin e riviktimizimit. Disa prej tyre kanë arritur të ecin përpara me jetët e tyre, pavarësisht përvojës, ndërkohë që të tjerë nuk kanë arritur ta bëjnë këtë. Për më tepër, situata politike në vend apo në rajon, opinioni publik mbi aktin terrorist specifik, vetë sulmi terrorist, si dhe rrethanat kulturore dhe ato historike mund të ndryshojnë nga një rast në tjetrin. Pyetja është, si mund të përdoret zëri i viktimave në favor të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm?

Shumë viktime të terrorizmit dëshirojnë të ndërmarrin veprime aktive për të parandaluar ripërsëritjen e asaj që ka ndodhur. Disa prej tyre organizojnë një ditë përkujtimi në nder të viktimave të një sulmi terrorist, ndërkohë që të tjerë zgjedhin të angazhohen me viktime të sulmeve të tjera apo me komunitete. Në kuadër të objektivave të RAN, viktimat e terrorizmit konsiderohen zëra të besueshëm që dëshmojnë pasojat e dhimbshme të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Viktimat janë përfaqësues dhe ambasadorë të kujtesës publike. Zëri i tyre mund të ofrojë një rrëfim të fuqishëm, duke kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit ndaj radikalizmit dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Dëshmitë e viktimave mund të nxisin ndryshime dhe t'i japin audiencës së synuar mundësinë për të reflektuar mbi historinë dhe për të gjetur veten tek ajo.

Misioni i RAN VVT është t'u japë një zë viktimave, të vërë në dukje vlerat e tyre pozitive dhe të fuqizojë rolin e tyre si një mjet efektiv në ndërgjegjësimin e njerëzve ndaj rreziqeve të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Viktimat janë shndërruar në përfaqësues të asaj çfarë aktet terroriste shkaktojnë mbi jetët e qytetarëve të zakonshëm. Ky mesazh duhet të përhapet në mënyrën më efektive, për të parandaluar që njerëzit të tërhiqen prej lëvizjeve ose propagandave radikale, t'i konsiderojnë ato të lejueshme apo të tregohen indiferentë ndaj tyre.

Komunikimi i dëshmimeve të viktimave te publiku i gjerë apo te grupe specifike të fokusit nga njëra anë, dhe mbrojtja e interesave dhe mirëqenies së viktimave (organizatave) nga ana tjetër, përbën një sfidë delikate. Këtu hyjnë në lojë edhe faktorët etikë, ligjorë, politikë dhe akademikë. Duke kërkuar praktika dhe qasje të mira, duke angazhuar specialistë akademikë dhe duke ruajtur një qasje inovative, RAN VVT përpiqet të krijojë një standard të ri për t'i dhënë një zë viktimave. RAN VVT do t'i promovojë këto standarde dhe do të ndihmojë në marrjen dhe shpërndarjen e dëshmimeve.

Dhënia e dëshmimeve përpara një audience është një proces kompleks, dhe efekti i tij varet nga shumë faktorë të ndryshueshëm. Dëshmitë janë të formave të ndryshme: dëshmi të drejtpërdrejta të dhëna ballë për ballë; dhe dëshmi të tërthorta që përcillen nëpërmjet fotografisë, filmit, internetit dhe mediave sociale. Rol vendimtar nuk ka vetëm vetë historia - kanë gjithashtu edhe elementë të tjerë të rëndësishëm: si përcillet historia, nga kush, ku, përmes cilit kanal, me çfarë objektivi dhe te cila audiencë? Çështja e efektivitetit mund të trajtohet nga këndvështrime dhe nga aktorë të ndryshëm (si p.sh. nga grupi i synuar, rrëfimtaret, ndërmjetësi, etj.).

1.2 Synimi i këtij manuali

Ky manual është një përmbledhje e përvojave të shkëmbyera gjatë takimeve të RAN VVT të zhvilluara nga viti 2012 deri në vitin 2015. Grupi i punës RAN VVT mori në konsideratë mënyrën sesi dëshmitë e viktimave të terrorizmit mund të shërbejnë si një rrëfim i fuqishëm në kuadër të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Synimi është të ndahen përvojat e shkëmbyera, dhe të ofrohet mbështetje jo vetëm për viktimat e tjera dhe organizatat e viktimave, por edhe për një audiencë më të gjerë: edukatorë, persona që punojnë me të rinjtë dhe profesionistë të tjerë që punojnë për parandalimin apo luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (p.sh. personeli i burgjeve/shërbimit të provës apo policia komunitare).

Manuali ofron këshilla praktike mbi mënyrat e rritjes së efektivitetit të dëshmimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta dhe mbi kushtet paraprake të kërkuara, si dhe mbi marrëdhënien e viktimës (apo organizatës së viktimave) me median dhe mbi mënyrën e bashkëpunimit me ish-ekstremistët. Përdorimi i dëshmimeve të viktimave përbën një çështje delikate, me shumë faktorë që ndikojnë. Për rrjedhojë, ky manual nuk duhet të konsiderohet si një material gjithëpërfshirës, dhe përdorimi i dëshmimeve duhet të përshtatet gjithmonë me rrethanat specifike.

1.3 Struktura

Manuali hapet me përshkrimin e kontekstit dhe rrethanave të viktimave të terrorizmit dhe të organizatave të tyre, me qëllimin për të kuptuar më mirë faktorët që duhet të merren në konsideratë përpara se viktimat të mund të kontribuojnë në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm (Kapitullit 2). Kjo pasohet nga një përshkrim i dëshmimeve të ndryshme të përdorura për rritjen e ndërgjegjësimit dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe i efektivitetit të tyre. Bëhet dallimi mes dëshmimeve të drejtpërdrejta dhe atyre të tërthorta, dhe theksohet përdorimi i internetit dhe i mediave sociale (Kapitulli 3). Viktimat dhe organizatat e viktimave kontaktohen shpeshherë nga mediat, kryesisht pas një sulmi terrorist. Për rrjedhojë, kapitulli 4 i përkushtohet marrëdhënies me median, përgjigjes ndaj kërkesave të medias dhe anasjelltas, tërheqjes së vëmendjes së saj. Bashkëpunimi i mundshëm me viktimat dhe ish-ekstremistët dhe kushtet paraprake për angazhimin në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm janë theksuar në kapitullin 5.

Kapitulli 2: Situata e viktimave të terrorizmit dhe organizatave të viktimave

2.1 Konteksti

Qëllimi primar i RAN VVT është të ndihmojë në luftën kundër radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm. Megjithatë, është me rëndësi thelbësore ngritja e standardeve themelore për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të terrorizmit, duke qenë se njohja e këtyre të drejtave përbën parakusht për përdorimin e tyre si mjete me rëndësi themelore në rritjen e ndërgjegjësimit ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Njohja e të drejtave të viktimave të terrorizmit të dhunshëm është thelbësore, edhe pse ajo nuk përbën fokusin primar të këtij manuali.

Aftësia e një viktime apo e një organizate viktimash¹ për të kontribuar në një program për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm varet nga rrethanat personale apo emocionale të viktimës, nga efektiviteti i organizatës së viktimave, dhe nga niveli i përgatitjes së rrëfimitarit dhe marrësve. Situata politike, kulturore dhe historike në vend është po aq e rëndësishme. Organizatat

¹ Termi «organizata të viktimave», sipas përdorimit në këtë dokument, nënkupton organizatat dhe shoqatat e viktimave, grupet e vetëndihmës, grupet mbështetëse dhe grupet e interesit.

e viktimave mund të shndërrohen në pikën qendrore të kontaktit me personat e prekur nga terrorizmi për shoqërinë civile dhe organet qeveritare (lokale, rajonale apo kombëtare). Këto organizata mund të shndërrohen njëkohësisht në zëdhënëse të viktimave të publiku i gjerë.

Me qëllimin për të mbështetur viktimat e terrorizmit dhe organizatat e tyre apo për të bashkëpunuar me to, është thelbësore të kuptohen rrethanat dhe dinamikat specifike me të cilat ato përballen, qoftë menjëherë pas ngjarjes apo shumë vite pas saj. Sa më mirë t'i kuptojmë vështirësitë e tyre, aq më shumë mund të bëjmë për të nxitur procesin e tyre të rikuperimit dhe për të vendosur drejtësinë në vend për ta - dhe aq më shumë mund të kontribuojnë organizatat e viktimave në rritjen e ndërgjegjësimit ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Prandaj, është thelbësore që t'i mbështesim këto grupe në punën e tyre dhe t'i ndihmojmë njerëzit të përballen me rrethanat tragjike dhe të rifitojnë pavarësinë e tyre në shoqëri. Kjo përfshin ofrimin e të gjithë mbështetjes së nevojshme emocionale, psikologjike dhe praktike që mund t'u nevojitet viktimave dhe të afërmeve të tyre për t'u rikuperuar.

Mbrojtja ligjore, barazia mes viktimave dhe pavarësia nga qeveria përbëjnë parakushte thelbësore. Të qenit i pavarur nuk nënkupton mosgatishmëri për të bashkëpunuar. Aty ku objektivat janë të përbashkët, si në rastin e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm, kjo konsiderohet madje si nevojë.

Për më tepër, qeveritë duhet të mbështetin viktimat dhe krijimin e organizatave të viktimave. Lehtësitë mund të krijohen në forma të ndryshme: për shembull nëpërmjet mbështetjes financiare apo ndihmës në sajë të ekspertizës specifike të kërkuar. Qeveritë (në nivel vendor, rajonal, kombëtar dhe evropian) mund të ofrojnë gjithashtu një platformë nëpërmjet së cilës organizatat të mund të aksesojnë shërbimet e komunikimit publik, dhe të mbështesin projektet dhe aktivitetet e tyre në lidhje me komunikimin. Institucionet e financuara nga shteti apo ato shtetërore, të tilla si shkollat, mund të inkurajohen fuqimisht që të jenë të hapura ndaj dhënies së dëshmimeve që lidhen me luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Kjo mbështetje nuk nënkupton rënien dakord mbi çdo aspekt (ç'është e vërteta, qeveritë dhe organizatat e viktimave mund të kenë ndonjëherë pikëpamje të kundërta). Megjithatë, respekti i ndërsjellë duhet të ekzistojë gjithmonë.

Së fundi, është thelbësore që qeveritë t'i njohin të gjitha viktimat e terrorizmit, pavarësisht karakterit politik, ideologjik apo fetar të aktit terrorist prej të cilit ato janë prekur. Diskriminimi ndërmjet grupeve të viktimave të prekura nga incidente të ndryshme terroriste mund të shkaktojë përçarje, dhe të reduktojë apo pengojë kohezionin social dhe kapacitetin e organizatave të viktimave për të kontribuar në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Projekti »Të mbijetuarit për paqen« i ndërmarrë nga Fondacioni i Paqes »Tim Parry dhe Johnathan Ball« (Mbretëri e Bashkuar) u ofron viktimave të mundshme të dhunës politike dhe terrorizmit një rrjet virtual dhe real të mbështetjes, ku zyrtarë të dedikuar mbajnë në funksionim platforma komunikimi, si dhe një program aktivitetesh në të cilin të mbijetuarit mund të regjistrohen pas një interviste intensive ballë për ballë.

Të mbijetuarit (duke përfshirë anëtarët e familjes dhe ish-ekstremistët) i nënshtrohen një trajnimi interaktiv dhe joformal, dhe atyre u ofrohet mbështetje pranë Qendrës së Paqes të ngritur për këtë qëllim si dhe pranë qendrave të tjera, me synimin për t'i ndihmuar ata në përballjen me përvojat e tyre dhe në rikuperim. Nëpërmjet seancave mbi përballjen me traumat dhe nëpërmjet shkëmbimit të përvojave, të mbijetuarit trajnohen dhe mbështeten për t'u angazhuar në aktivitetet e tyre të advokimit dhe lidhshimit, shpeshherë nëpërmjet përkujtimit të ngjarjeve dhe rritjes së ndërgjegjësimit ndaj ndikimit të ekstremizmit të dhunshëm, me synimin për të reduktuar përsëritjet e këtij fenomeni.

Nëpërmjet trajnimit dhe mbështetjes së ofruar nga ekspertë, të mbijetuarit kontribuojnë gjithashtu në trajnimin e ofruar nga një ekip specialistësh për incidentet e rënda, për të ndihmuar në përgatitjen e ofruesve të ndihmës së parë në rastin e një sulmi terrorist.

Aktivitetet përfshijnë gjithashtu dialogun, ku të mbijetuarit inkurajohen të takohen me ish-ekstremistë apo me përfaqësues të »anës tjetër« me qëllim humanizimin reciprok dhe thyerjen e ciklit të dhunës.

Shih në internet: <http://www.foundation4peace.org/>

2.2 Njohuri të rëndësishme²

Jo çdo viktimë dëshiron të dëshmojë, dhe jo të gjitha janë të aftë ta bëjnë; ne nuk duhet të tregohemi kritikë apo paragjykes në raste të tilla. Rrëfimi i një dëshmie në rolin e viktimës është një barrë e madhe emocionale. Për rrjedhojë, organizatat e viktimave që punojnë në fushën e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm duhet të punojnë vetëm me viktimat të cilat janë të gatshme dhe të afta të përfshihen në punën e parandalimit të ekstremizmit ekstrem si folës, shkrimtarë, organizatorë, etj.

Viktimat duhet t'i menaxhojnë vetë pasojat personale (psikologjike dhe fizike) të së shkuarës së tyre, dhe kjo është diçka që duhet marrë në konsideratë. Çdo viktimë ka historinë dhe rrethanat e saj. Viktimat që ndajnë historinë e tyre kanë arsye dhe motive të ndryshme për ta bërë këtë. Rrëfimi i një dëshmie në rolin e viktimës është një barrë e madhe emocionale: kjo harrohet shpeshherë. Edhe nëse ofrohet mbështetje, personat mund të vendosin ta ndërpresin në mënyrë të përkohshme apo të përhershme dhënien e dëshmisë së tyre: për shembull, ata mund ta kenë të pamundur të përballen me këtë barrë, apo mund të jenë të pakënaqur me mënyrën sesi trajtohen. Organizatat e viktimave duhet të garantojnë parandalimin e riviktimizimit të viktimave si pasojë

² Guidebook, Together we are smarter and stronger! (2008) Ms I. Cancrinus and Ms J. C. M. Netten MSc, MA. Impact

e dëshmisë së tyre. Personave që japin apo bëjnë publike dëshmitë e tyre duhet t'u ofrohet mbështetje në përballjen me traumën që shkakton ky proces.

Vajtimi

Viktimave u është dashur të përballen me situata të tmerrshme. Jetët e tyre kanë ndryshuar rrënjësisht dhe nuk do të jenë më kurrë njësoj. Ata mund të kenë pësuar shumë humbje: mund të kenë humbur njerëzit e tyre të dashur, integritetin e tyre fizik, punën, të ardhmen, dhe madje edhe besimin e tyre te jeta dhe bota. Shkurtimisht, ata kanë shumë humbje për të vajtuar dhe emocione për të menaxhuar; si dhe kanë nevojë të theksuar për njohje ligjore dhe sociale, ndihmë emocionale dhe praktike dhe informacion. Siç është përmendur edhe më lart, organizatat e viktimave të terrorizmit mund të kontribuojnë në këtë proces duke ofruar informacion (i cili varion nga çështjet ligjore deri tek adresat e terapistëve të specializuar), këshillim, udhëzim, njohje, mbështetje, etj.

Vajtimi është një proces thellësisht individual, personal dhe unik; çdo person vajton dhe e shpreh dhimbjen në mënyrën, etj. Vajtimi prek jo vetëm anëtarët e familjes, por edhe miqtë, fqinjët, kolegët, komunitetin apo edhe kombin. Organizatat duhet të jenë veçanërisht të vetëdijshme ndaj nevojave të ndryshme, shkallëve të ndryshme të rikuperimit dhe mënyrave të ndryshme të shprehjes së dhimbjes dhe brengosjes tek të afërmit e personave të vdekur, te fëmijët, të rinjtë, prindërit, vëllezërit, motrat dhe të mbijetuarit.

Aftësia rikuperuese

Historia e njerëzimit karakterizohet nga shumë periudha tronditëse dhe të dhunshme: luftërat, fatkeqësitë dhe aksidentet kanë ndikuar mënyrë të konsiderueshme në strukturën individuale dhe sociale të shumë zonave. E megjithatë, përmes vuajtjeve dhe pasojave të këtyre veprimeve, njerëzit kanë demonstruar gjithashtu edhe aftësinë e tyre për t'u rikuperuar. Në shumë raste, njerëzit mund të përballen me rrethana nga më të vështirat e megjithatë të rikuperohen; duke gjetur forcën për të dalë mbi mjerimin e tyre. Rrethi i personave të afërt - familjarët e afërt, miqtë, fqinjët, klubet dhe komunitetet fetare - mund të japin një ndihmë të madhe në këto raste. Një dëgjues miqësor dhe oferta për ndihmë praktike mund ta ndihmojnë personin e prekur nga fatkeqësia të ndihet më pak i izoluar, gjë që nga ana tjetër mund t'i motivojë dhe t'i inkurajojë viktimat të rrisin aftësinë e tyre rikuperuese.

Statusi i viktimës

Pjesëmarrja në një organizatë viktimash dhe dhënia e dëshmimeve është padyshim për t'u lëvduar, dhe mund të ketë një ndikim pozitiv mbi shumë persona, ndër të tjera edhe në procesin e rikuperimit. Megjithatë, në një numër të vogël rastesh, ekziston rreziku që »statusi i viktimës« ta vendosë individin në një pozitë më të dobët në vend që ta fuqizojë atë. Kjo nënkupton identifikimin e tij në një shkallë të dëmshme (në rritje apo të plotë) me aktin terrorist dhe pasojat e tij, duke mos lënë më vend për aspektet e tjera të jetës (së tij). Këta persona mbeten të fokusuar tek aspektet problematike dhe të dëmshme të incidentit, madje edhe pas një kohe të gjatë, dhe mund ta kenë gjithnjë e më të vështirë apo madje edhe të pamundur të shohin drejt së ardhmes apo të

fokusohen te rikuperimi, gjë që i bën ata të varur dhe pasivë. Është thelbësore që organizatat e viktimave të terrorizmit të jenë në dijeni të këtyre rasteve, t'i identifikojnë ato dhe t'i inkurajojnë këta njerëz të kërkojnë ndihmë profesionale (në rast se kjo ndihmë nuk ofrohet nga organizata e viktimave) dhe të përpiqen të gjejnë një ekuilibër të ri. Në këto raste, përdorimi i dëshmimeve të tyre për të kundërshtuar ekstremizmin e dhunshëm mund të ketë efekt negativ, pasi ai mund t'i vendosë viktimat në pozita më të dobëta në vend që t'i ndihmojë ato të rikuperohen.

Hierarkia e vuajtjes

Një nga tendencat e zakonshme të njeriut është krahasimi i pozicionit apo rrethanave të tij me ato të dikujt tjetër: a jemi më të mirë, më të pasur, më të rëndësishëm dhe të fuqishëm se të tjerët, apo jemi më keq se ata? Kjo tendencë mund t'i lërë vend një fenomeni të spikatur shpeshherë te viktimat: hierarkia e vuajtjes, apo krahasimi se kush vuan më shumë. Viktimat dhe të afërmit e tyre mund të bëjnë krahasime të situatave të tyre - në mënyrë të heshtur apo të shprehur, duke vlerësuar se kush mund të konsiderohet më tepër si viktimë, duke merituar kështu më shumë vëmendje, njohje dhe mbështetje. Pala që shihet më pak si viktimë mund të konsiderohet se e meriton më pak këtë ndihmë. Është e vështirë të përballesh me këto situata, por njohja e kësaj lloj sjelljeje mund të ndihmojë në identifikimin dhe parandalimin e këtyre proceseve. Hierarkia e vuajtjeve mund t'i bëjë viktimat të stepen përpara kërkimit dhe pranimit të ndihmës, si dhe mund të pengojë ofruesit e kujdesit për të ndihmuar personat në nevojë.

Rrëfimi i historive në kuadër të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm

Zakonisht, historitë e viktimave studiohen dhe analizohen duke përdorur »rrëfimin terapeutik« - një metodë për kapërcimin e traumave të viktimave dhe komuniteteve. Grupi kryesor i synuar për këtë rrëfim është vetë viktimat: duke bërë të mundur që ajo të flasë rreth asaj që i ka ndodhur dhe të kapërcejë pengesat mendore. »Specialistët e shëndetit mendor, infermierët e shëndetit mendor, psikiatrit për rastet e emergjencës dhe shkrimtarët kanë përkrahur me kohë kontributin e letërsisë, të shkruarit ekspresiv, rrëfimit terapeutik dhe terapisë poetike në shëndetin e pacientëve në mjedise klinike«³

Interesi ynë qëndron në kalimin nga mjediset klinike, shëndetësore dhe të mbrojtura tek ato publike, politike dhe pedagogjike: ku rrëfimi shndërrohet në një mënyrë për të fuqizuar qytetarët duke u dhënë atyre një zë. Në këtë rast, roli i rrëfimit shkon përtej çlirimit shpirtëror; ai është gjithashtu një mënyrë për të transformuar një histori të ndrydhur në një histori që i përket të gjithë kombit: siç ishte rasti i të mbijetuarve të aparteidit në Afrikën e Jugut, apo rasti i të mbijetuarve të kampeve naziste të përqendrimit në Evropë.

³ Enhancing Counter-Terrorism Strategies Through Visual Storytelling Techniques and Community-Empowered Ethnographies, by Sudha ARLIKATTI and Melinda LEVIN, in Counter Terrorism in Diverse Communities, S. Ekici (Ed.) IOS Press, 2011.

2.3 Përgatitja e viktimave për dhënien e dëshmisë së tyre

Parakushtet

Shumë organizata viktimash ofrojnë mbështetje për viktimat në përgatitjen për të dëshmuar. Përgatitja është me rëndësi thelbësore për arsye të sigurisë personale. Ajo luan një rol kyç në përcjelljen e një mesazhi sa më efektiv dhe për sigurimin e një mjedisi sa më të përshtatshëm për dhënien e dëshmisë.

Një nga parakushtet për një përgatitje të suksesshme është ekzistenca e besimit ndërmjet viktimës dhe organizatës së viktimave. Nevojitet gjithashtu një atmosferë pozitive dhe e hapur. Hapi i parë është krijimi i një marrëdhënieje të respektueshme. Njerëzve u duhet kohë për t'u rrëfyer. Krijimi i një atmosfere të ngrohtë dhe lënia e një kohe të mjaftueshme për të bashkëbisedim, shkëmbim përvojash dhe për të dëgjuar njëri-tjetrin është thelbësore.

Do të duhet pak kohë përpara se personat të jenë gati të ritregojë historitë e tyre. Viktimat do të ripërzetojnë përvojat e tyre dhe do të shprehin edhe njëherë brengat e tyre. Bisedat e para do të rrotullohen rreth ngjarjes konkrete dhe do të japin detaje mbi ngjarjet. Kjo do të pasohet nga diskutime mbi autorin, si dhe mbi familjen e viktimës dhe mbi ndjenjat e saj. Megjithatë, ky proces nuk mjaftohet thjesht me disa biseda. Përmes punës në grup, shkëmbimit të historive me viktima të tjera, vizitave pranë një këshilluesi dhe angazhimit në kontakte dhe miqësi personale, çdokush mund të krijojë një rrjet mbështetjeje dhe të arrijë një bashkëpunim të përjetshëm. Kjo është e domosdoshme, pasi vetëm duke e njohur mirë dikë mund ta ndihmojmë atë dhe të kuptojmë kur ai është duke arritur limitet e tij. Për më tepër, krijimi i një rrjeti të viktimave të terrorizmit mund të favorizojë viktimat, duke u siguruar atyre mbështetje në sajë të shkëmbimit të përvojave dhe historive me viktima të tjera.

Krahas këtij procesi, për viktimat duhet të ofrohet edhe trajnim për⁴ trajtimin e çështjeve të tilla si:

- si të tregojnë historinë e tyre;
- si të përballojnë emocionet e tyre gjatë rrëfimit të historisë;
- si të përdorin objekte, piktura dhe materiale audio-vizuale;
- si ta përshtatin historinë për një grup specifik të synuar, si p.sh. për adoleshentët;
- si të përballen me pyetje të vështira;
- si të përballen me audienca problematike;
- si ta tregojnë historinë e tyre si pjesë e një mesazhi universal, më të gjerë.

Në shkolla

Në rastet kur viktimat do të shkojnë nëpër shkolla për të dhënë dëshmitë e tyre, ata apo organizatat e tyre duhet të vizitojnë fillimisht shkollën dhe të takohen me mësuesit. Përpara dëshmisë, të rinjve duhet t'u jepet informacioni përkatës dhe ata duhet të angazhohen në një diskutim mbi temën (për të fituar disa njohuri). Të rinjtë duhet të informohen, nxiten dhe motivohen paraprakisht, pasi disa prej tyre mund të jenë të turpshëm, të trembur apo të painteresuar për temën. Përpara se të

⁴ Shumë prej etapave të një trajnimit mund të gjenden në këtë manual. Megjithatë, RAN nuk ka zhvilluar ende ndonjë trajnim.

dëgjojnë dëshminë, nxënësit dhe studentët mund të hartojnë një listë me pyetje të mundshme, të cilat mund të renditen sipas fakteve, përvojave personale, opinioneve, etj. Mund të jetë i dobishëm leximi i pyetjeve të nxënësve nga rrëfimtari përpara aktivitetit, në mënyrë që ai të krijojë një ide rreth projektit dhe audiencës.

Së fundi, është mjaft e rëndësishme që shkolla të kuptojë se ajo (së bashku me organizatën e viktimave) mban përgjegjësi për viktimën pas takimit me të rinjtë. Ripërballja me një ngjarje shqetësuese mund të ringjallë emocione të forta, ndaj mësuesit dhe stafi akademik duhet të lënë kohë mënjanë për të falënderuar viktimën dhe për të bërë një prezantim të shkurtër të saj.

Stafi akademik duhet të marrë udhëzime mbi trajtimin e pyetjeve të mundshme dhe trajtimin e sjelljeve sfiduese (qoftë thellësisht emocionale apo kundërshtuese). Përgatitja përfshin gjithashtu vendosjen e rrëfimeve në kontekst, p.sh. përmes integritit të programit në kurrikulën e edukimit qytetar, filozofisë apo historisë. Subjektet duhet të paraqesin interes për të rinjtë, në mënyrë që të tërheqin vëmendjen e tyre dhe t'u nxisin kureshtjen, siç janë për shembull rastet kur historitë e tyre i ndihmojnë të rinjtë të njihen më mirë me kulturat e huaja, me çështjet e globalizimit, etj. Në rastet kur programi shihet si pjesë e kurrikulës, ai gjen vazhdimësi dhe mbulim më të gjerë, dhe dëshmitë bëhen më të zakonshme për studentët. Së fundi, programi duhet të monitorohet dhe rezultatet e tij duhet të vlerësohen (nga organizatat e viktimave dhe shkollat, apo edhe nga ekspertët në nivel më akademik), për të lejuar propozimin e vlerësimeve, rregullimeve dhe përmirësimeve.

Kapitulli 3 Dëshmitë e viktimave të terrorizmit

3.1 Faktorët që ndikojnë në procesin e komunikimit

Dhënia e dëshmimeve përpara një audience është një proces kompleks, dhe efekti i tij varet nga shumë faktorë të ndryshueshëm. Dëshmitë janë të formave të ndryshme: dëshmi të drejtpërdrejta të dhëna ballë për ballë; dhe dëshmi të tërthorta që përcillen nëpërmjet fotografisë, filmit, internetit dhe mediave sociale. Rol vendimtar nuk ka vetëm vetë historia - kanë gjithashtu edhe elementë të tjerë të rëndësishëm: si përcillet historia, nga kush, ku, përmes cilit kanal, me çfarë objektivi dhe te cila audiencë? Çështja e efektivitetit mund të trajtohet nga këndvështrime dhe nga aktorë të ndryshëm (si p.sh. nga grupi i synuar, rrëfimtarët, ndërmjetësi, etj.).

Ka disa faktorë mjaft të rëndësishëm që mund ta shndërrojnë zërin e viktimës në një mjet efektiv për ndërmarrjen e veprimeve parandaluese, si p.sh. edukimi, shkencat sociale dhe ato të sjelljes, komunikimi bindës, rinia dhe media, madje edhe marketingu. Gjatë përdorimit të dëshmimeve, është thelbësore ekzistenca e njohurive mbi procesin kompleks të komunikimit të saj dhe mbi faktorët e ndryshëm që ndikojnë në këtë proces.

3.2 Efekti i dëshmime

Një prej elementëve më efektivë të dëshmime të viktimave të terrorizmit është fakti se njerëzit kanë tendencën të gjejnë veten tek ato. Dëshmia jep një imazh më njerëzor të subjektit, duke lënë pas elementët thellësisht faktikë (të tillë si numri i personave të vdekur, përshkrimi i rrethanave, etj). Historitë personale të viktimave kanë dy efekte. Ato vendosin një fytyrë pas personave të sulmuar, si dhe tregojnë sesi mund të preken njerëzit e zakonshëm dhe sesi ata përballen me situata tronditëse dhe pikëlluese. Sa më shumë t'i shohim viktimat si pjesë e jona, aq më i madh do të jetë ndikimi i mesazhit të tyre tek audienca. Rrëfimi i historive të viktimave përpara komuniteteve të tyre do ta rrisë edhe më shumë këtë efekt.

Rrëfimet e viktimave u drejtohen aktorëve si shkollat, qendrat komunitare, OJQ-të dhe qeverisja vendore. Këta aktorë mund të vënë në qendër të vëmendjes perspektivën e viktimave në rrëfimin e tyre mbi ekstremizmin e dhunshëm. Përqendrimi vetëm tek autorët, pa treguar pasojat e veprimeve të tyre, mund të lartësojë dhe të idealizojë imazhin e autorit te grupe të cilat janë të ndjeshme ndaj mesazheve radikale. Aktorët në nivel lokal do të jenë më në dijeni të situatës (politike) të zonës ku mund të jetë duke ndodhur procesi i radikalizmit. Kjo u ofron atyre mundësinë për të kërkuar në mënyrë më specifike dëshmitë e duhura, në kohën e duhur dhe në situatën e duhur, dhe për t'i komunikuar këto dëshmi te grupet apo audienat e duhura.

»Dëshmitari i historisë« (Austri), një projekt i »Sisters Against Violent Extremism« (SAVE), i prezanton të rinjtë gjatë viteve të formimit të tyre me realitetin e ideologjive të ekstremizmit të dhunshëm, dhe paraqet alternativa ndaj hakmarrjes. Historitë personale kanë aftësinë për t'i prekur audienat më shumë se fjalimet zyrtare dhe analizat abstrakte. Viktimat dhe të mbijetuarit flasin nga një këndvështrim autentik, me autoritet moral dhe me bindje personale.

Filmat e »Dëshmitari i historisë« u japin fytyra njerëzore sulmeve terroriste tragjike, dhe krijojnë një kundërpeshë të fuqishme ndaj propagandës ekstremiste.

Historitë personale të viktimave, përvojat e hidhura të të cilave i kanë bërë ato më të forta dhe të afta për të mbajtur një qëndrim pozitiv, ndihmojnë në rrëzimin e barrierave të të menduarit »bardhë e zi«. Ato mbjellin farën e dyshimit në mendjet e atyre që mund të jenë në mbështetje të dhunës, apo të cilëve u mungojnë alternativat. Kjo është një qasje e »të fituarit të zemrave dhe mendjeve«, e cila synon zhvillimin e të menduarit kritik si pengesë ndaj radikalizmit.

Shih në internet: <http://www.women-without-borders.org/projects/37>

3.3 Dëshmitë e drejtpërdrejta

Dëshmitë e drejtpërdrejta janë dëshmitë e dhëna nga viktimat përpara një audience të caktuar, si për shembull përpara të rinjve në shkolla. Audienat preken nga prania fizike e viktimës që tregon historinë e saj personale. Ekziston një kontakt i ndërsjellë mes dhënësit dhe marrësit të një

dëshmie, ndaj sinqeriteti, keqardhja dhe mesazhi njerëzor bëhen drejtpërdrejt të ndjeshme nga audienca. Përmbajtja dhe mënyra e rrëfimit është në dorën e vetë viktimës. Diskutimi përbën pjesë të dëshmisë. Viktima mund t'u përgjigjet pyetjeve dhe të marrë pjesë në diskutime pas dëshmisë. Efektiviteti i një dëshmie lidhet ngushtë me mënyrën sesi ajo rrëfëhet nga viktima. Sjellja dhe gjendja emocionale e viktimës ndikon në dëshmi, dhe për rrjedhojë edhe te publiku. Rreziqet për viktimat që japin dëshmi të drejtpërdrejta përfshijnë ndikimin e mundshëm të ripërjetimit të traumës, paragjykimet e mundshme dhe mbingarkesën emocionale.

»Omagh Support and Self Help Group« (OSSHG) (Mbretëri e Bashkuar) organizon projekte të rrëfimit të historive nëpër shkolla, me qëllim ndërgjegjësimin mbi ndikimet e radikalizmit. Ato theksojnë se të rinjtë janë jashtëzakonisht të prekshëm dhe duhet të mësojnë më shumë për qytetarinë aktive, bashkëpunimin social, diversitetin kulturor etj., si pjesë të edukimit qytetar në shkolla.

Shih në internet: <http://www.omaghbomb.co.uk>

3.4 Dëshmitë e tërthorta (fotografi/filma/dokumente)

Dëshmitë e tërthorta të viktimave të terrorizmit e paraqesin historinë e viktimës pa praninë fizike të saj, p.sh. nëpërmjet një filmi apo libri. Avantazhet e tyre janë arritja e një audience më të madhe me më pak përpjekje dhe mundësia e shtimit të efekteve vizuale dhe audio. Megjithatë, kjo metodë ka sfidat e saj: efikasiteti i panjohur i dëshmimeve si një fragment kundër-komunikimi kundër ekstremizmit të dhunshëm, humbja e kontrollit mbi mesazhin dhe/ose keqpërdorimi i mundshëm i mesazhit, si dhe mungesa e reagimeve.

Burimet e tërthorta, si librat, fotografitë apo filmat mund të tregojnë një histori të plotë nga perspektiva të ndryshme. Kjo mund të nxisë reflektimin tek audienca. Thirrja emocionale për të ngjallur empati tek audienca mbështet mesazhin e dëshmimeve. Dinamikat e grupeve mund të përdoren pozitivisht gjatë diskutimit të burimit të tërthortë, nëse udhëzohen dhe përgatiten mirë.

Burimet e tërthorta të dëshmimeve mund të kombinohen me vizita studimore në muze, monumente përkujtimore apo në vende ku kanë ndodhur sulme. Është gjithashtu e dobishme mbështetja e programit nga një portal apo faqe interneti që përmban dokumente, fotografi, video etj., përkatëse dhe plotësuese. Në çdo vend mund të zgjidhet një përmbledhje e burimeve të drejtpërdrejta (tërthorta) të dëshmimeve për t'u përdorur në programet e tyre kombëtare apo në kurrikulën shkollore.

»Associazione Italiana Vittime del Terrorismo e dell'Eversione Contro l'Ordinamento Costituzionale dello Stato« (AIVITER) (Itali) krijoi një modul trajnimi për sistemin arsimor, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për dhunën ekstremiste dhe nxitjen e qytetarisë aktive mes të rinjve.

Në këtë modul trajnimi përdoren histori dhe dëshmi të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të të mbijetuarve, anëtarëve të tyre të familjes dhe viktimave të terrorizmit. Nisur nga sfidat aktuale të terrorizmit, dëshmitë dhe materialet multimediale të historive të viktimave përdoren për të reflektuar mbi ngjarje të ngjashme në historinë italiane; ato rrisin ndërgjegjësimin dhe informimin/njohuritë për terrorizmin kombëtar dhe rrënjët historike dhe kulturore. Ndërgjegjësimi për përdorimin e dhunës në politikë dhe për rrezikun e përfshirjes në ekstremizmin e dhunshëm i nxit të rinjtë të zhvillojnë të menduarin kritik.

Për më tepër, rrëfimi i historive nga të mbijetuarit/viktimat, në vetën e parë dhe përpara publikut, i fuqizon këto të fundit duke ndikuar në rritjen e aftësisë së tyre rikuperuese, si dhe të statusit dhe rolit të tyre shoqëror.

Shih në internet: <http://www.vittimeterrorismo.it>

Ekziston nevoja për dëshmi më të shumta dhe të ndryshme, pasi persona të ndryshëm përfshihen me histori apo ngjarje të ndryshme. Një gamë e gjerë dëshmish nënkupton më shumë zgjedhje kur kërkon diçka të përshtatshme për një grup të synuar specifik.

3.5 Udhëzime për përdorimin e dëshmimeve

Në rastin e përdorimit të dëshmimeve të viktimave për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm, gjejnë zbatim disa udhëzime, të cilat shpjegohen më poshtë.

- Dëshmitë e izoluara dhe të veçanta janë më pak të dobishme. Dëshmitë duhet të jenë pjesë e një programi më të madh dhe të integrohen në sistemin arsimor dhe në shoqërinë civile për mbështetjen sociale dhe seancat e trajnimit për specialistët e vijës së parë, fushatat në nivel lokal/kombëtar, OJQ-të, edukatorët dhe personelin e burgjeve.
- Këshillohet fort që viktimat të punojnë në bashkëpunim me një organizatë për mbështetjen e viktimave. Organizatat për mbështetjen e viktimave mund të mbështesin, përgatisin, koordinojnë dhe trajnojnë viktimat në lidhje me dhënien e një dëshmie për një audiencë të caktuar. Nëse ato punojnë të vetme, kjo mund të jetë e dëmshme për vetë viktimën, madje mund të dëmtojë edhe kauzën e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm. Për të qenë efektive dhe për të mbrojtur veten e tyre, viktimat duhet të punojnë me specialistët dhe viktimat e tjera me të cilat ato mund të ndajnë përvojën e tyre dhe të cilave mund t'u paraqesin pyetjet, dyshimet dhe nevojat e tyre. Një viktimë e vetmuar mund të ndihet e izoluar dhe ka më shumë gjasa të shprehë një mesazh agresiv dhe të pikëlluar, i cili mund të ketë efekt negativ për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.
- Motivimi për të treguar historinë nuk duhet të jetë as vlerësimi, as mirënjohja. Ai duhet të ketë një qëllim më të gjerë.
- Dëshmitë duhet të jenë të fokusuar, me një qëllim të caktuar për një audiencë të caktuar.

- Dëshmitë duhet të përfshijnë reflektim (analizën retrospektive dhe nxjerrjen e mësimave nga e shkuara), me qëllim bërjen e një ndryshimi në të tashmen dhe të ardhmen.
- Është mjaft e rëndësishme të ruhet cilësia e dëshmisë dhe që dëshmia të mbahet e përditësuar, me qëllim ruajtjen e fuqisë së saj.
- Konteksti politik i një rrëfimi nuk duhet të jetë thelbësor; në epiqendër duhet të jetë konteksti dhe procesi historik dhe demokratik. Viktima nuk supozohet të bindë apo indoktrinojë audiencën. Nëpërmjet rrëfimit dhe tregimit të përvojës së saj personale, viktima synon të reflektojë virtytet e vlerave demokratike dhe ciklin virtuoz të dialogut dhe respektit reciprok. Viktimat nxisin gjithashtu të menduarin kritik. Takimi nuk ka si objekt kryesor marrjen e miratimit apo arritjen e një kompromisi me audiencën, por që audienca të dëgjojë rrëfimin e një përvoje reale dhe të reflektojë në lidhje me përmbajtjen (faktet) dhe emocionet. Sigurisht, mund të shprehen opinione politike, por ato nuk duhet të jenë epiqendra e historisë.
- Kur historia personale i referohet parimeve bazë të demokracisë, viktima mund ta bëjë rrëfimin e saj/tij më të fuqishëm për të rinjtë. Me përdorimin e parimeve të demokracisë, arrihet një ndikim më i madh edukativ.
- Mbani parasysh se dëshmitë mund të kenë rezultate negative: për shembull, njerëzit mund të perceptojnë konfirmim të ideologjisë apo mendimeve të tyre radikale. Mbani parasysh se dëshmitë e keqpërdorura mund të kenë rezultate negative; p.sh. mund të përdoren për të justifikuar idetë e papranueshme, si racizmi, teoritë e konspiracionit, justifikimi i terrorizmit.
- Dëshmitë duhet të fokusohen në historinë e viktimës, jo në prejardhjen apo qëllimin e autorit.
- Siguroni që seanca ka kohë të mjaftueshme për t'u angazhuar në dialog.
- Punoni në grupe të vogla.
- Në rolin e folësit të ftuar, mos humbisni në historinë tuaj dhe mos flisni shumë gjatë. Parashikoni kohë dhe hapësirë të mjaftueshme për bashkëbisedim.
- Rrethanat dhe historia duhet të theksojnë aspektin njerëzor dhe të tregohen me empati.
- Mund të përdoret një formular vlerësimi për një përmbledhje të ngjarjeve me viktimën dhe për të përmirësuar rrëfimin.
- Nëse dëshmitë janë përfshirë në programet arsimore, filloni që në fazë të hershme. Në fazën e hershme të adoleshencës, të rinjtë eksplorojnë format e identitetit, janë të prekshëm dhe të gatshëm për të dëgjuar rreth ngjarjeve aktuale dhe pasojave të tyre për shoqërinë. Kjo fazë e zhvillimit personal, ku fëmijët eksperimentojnë me identitetin, është me interes të madh. Në këtë rast është e rëndësishme që historia të përshtatet me audiencën dhe ndihma që ata të zhvillojnë aftësitë e të menduarit kritik.
- Programet arsimore që përdorin dëshmitë e viktimave mund t'i ndihmojnë të rinjtë të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të marrë pjesë aktive në një shoqëri demokratike dhe për t'u përpjekur që t'i zgjidhin konfliktet me mënyra paqësore. Ato ndihmojnë në kultivimin e një klime demokracie dhe kundërshtimi të dhunës, racizmit, intolerancës etj. Programet didaktike dhe pedagogjike (arsimore) duhet të nxisin analizën dhe të menduarit kritik tek të rinjtë. Komente të tjera të dobishme për fuqizimin e edukatorëve dhe shkollave në fushën e parandalimit të

radikalizmit që çon tek ekstremizmi i dhunshëm janë dhënë në *Manifesti për arsimin — Fuqizimi i edukatorëve dhe shkollave të RAN PREVENT*.⁵

- Kur një viktimë bëhet financiarisht e varur nga pagesa për dhënien e dëshmisë së saj, kjo i bën rrethanat të dyshimta. Viktimat janë dëshmitarë dhe zëra të sinqertë. Atyre duhet t'u ofrohet mbështetje dhe mbulim i shpenzimeve. Por, nëse ato paguhen sa herë që dëshmojnë, kjo do të kthehet në biznes dhe mund të çojë në konkurrencë kundërproduktive ndërmjet viktimave.

»Critical Mass« (Holandë) udhëton nëpër shkolla me pesë kontejnerë të mbushura me »përvoja«. Nxënësit inkurajohen të shqyrtojnë miqtë dhe armiqtë e tyre në një atmosferë të ngrohtë familjare. Cilët janë ata dhe si arritën në këtë pikë?

Qëllimi i »FRIEND&FOE« është pajisja e njerëzve (të rinjve), nxënësve dhe mësuesve të tyre me aftësitë e duhura për të trajtuar konfliktet në mënyrë konstruktive, si në jetën e tyre personale, edhe në shoqërinë e gjerë, si dhe për të parandaluar aktivisht përhapjen e ksenofobisë dhe radikalizmit, përjashtimit social, diskriminimit dhe ngacmimit.

Në orët shtesë, udhëheqësve ose mësuesve u jepet mundësia të diskutojnë çështje sociale në klasë dhe në shkollë, duke u mbështetur në përvojat e fituara nga nxënësit e tyre në kontejnerë. Orët mësimore zhvillohen në kurse specifike, si p.sh. në orët e këshillimit, historisë dhe studimeve sociale, por edhe në orët e edukimit të karrierës dhe qytetarisë, në arsimin profesional. Ky është një shembull i mënyrës së integritit të dëshmimeve në një program më të gjerë, duke pasur madje edhe orë mësimore shtesë.

Shih në internet: <http://www.criticalmass.nl>

3.6 Interneti dhe media sociale

Dëshmitë mund të regjistrohen në film dhe të publikohen online, për shembull në një kanal të »YouTube« ose në »Facebook«, ose mund të shpërndahen nëpërmjet mediave sociale ose emailit. Përdorimi i internetit mund të jetë i dobishëm për shpërndarjen e rrëfimeve. Interneti mundëson akses në një audiencë më të gjerë dhe përbën një mënyrë relativisht të lehtë shpërndarjeje. Për më tepër, shpërndarja merr më pak kohë dhe është më pak intensive për viktimën, e cila e jep dëshminë vetëm një herë, gjatë regjistrimit.

Sfidat kryesore të përdorimit të internetit janë mosnjohja e kontekstit dhe kohës së shikimit, si dhe e audiencës që shikon përmbajtjen. Për kontekste më të gjera, dëshmitë mund të mblidhen në një faqe interneti ose forum. Faqet e internetit mund të informojnë, frymëzojnë, ndërgjegjësojnë dhe aktivizojnë njerëzit, por mund të çojnë gjithashtu në krijimin e rrjeteve sociale dhe të ofrojnë një bibliotekë me informacione historike dhe seminare për mësuesit, si dhe ekspertizë për mediat. Disponueshmëria e një konteksti më të gjerë online mund të tërheqë më pak lexues.

Gjatë shpërndarjes së dëshmimeve nëpërmjet internetit dhe mediave sociale, duhet të mbahet parasysh se mund të ketë reagime negative kundrejt viktimës apo grupit të cilit i përket ai/ajo.

⁵ Shih në internet: http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/docs/manifesto-for-education-empowering-educators-and-schools_en.pdf

Veprimtaria online e viktimës mund të paraqesë disa rreziqe, si p.sh. keqpërdorimi i përmbajtjes apo një ndikim negativ te viktimave (ndaj reputacionit apo karakterit të saj), duke qenë se informacioni në internet është publik.

Ndonëse viktimat mund të konsiderohen të besueshme, përdoruesit e internetit mund të mos hyjnë në faqen e internetit të një organizate viktimash me dëshirën e qartë për të parë një dëshmi. Ndaj, dëshmitë duhet të përfshihen edhe në faqe të tjera interneti dhe të paraqiten edhe nga organizata të tjera, jo vetëm nga organizatat e viktimave. Për shembull, dëshmitë ose lidhjet e tyre mund të paraqiten në një komunitet të rinjsh në internet. Kjo është një qasje nga poshtë-lart, me një përcjellës më të besueshëm të mesazhit.

Kombinimi i aktivitetit online dhe offline, duke dhënë të njëjtin mesazh, duket se është më efektiv. Përmbajtja online shpesh nuk ka kontekst ose krijon një hendek ndërmjet grupit të synuar dhe personit që transmeton mesazhin. Ky hendek mund të plotësohet nga shpërndarja offline e informacionit. Po kështu, interneti dhe mediat sociale mund të shkaktojnë reflektim ose edhe hije dyshimi te disa persona. Vendosja e lidhjeve ndërmjet njerëzve (krijimi i lidhjeve) me mundësinë e ndryshimit të mendësisë së tyre është e vështirë të arrihet në anonimitet të plotë. Kontakti ballë për ballë me grupin e synuar është i rëndësishëm për ndërgjegjësimin dhe mund të ndryshojë sjelljet.

Efektet e aktivitetit online janë të vështira për t'u monitoruar. Është e vështirë të matet nëse një aktivitet arrin te një grup i synuar, dhe nëse ky i fundit merr mesazhin e duhur. Gjurmimi i rezultateve sasiore, si shikimet e faqeve, »pëlqimet« dhe lloje të tjera të informacioneve statistikore që mund të mblidhen lehtësisht nëpërmjet programeve softuerike, mund të ndihmojë për të parë nëse është arritur grupi i synuar. Megjithatë, kjo nuk do të sigurojë një pasqyrë të efekteve të mesazhit dhe të faktit nëse grupi i synuar ka deshifruar mesazhin e duhur. Për të përcaktuar efektet te grupi i synuar nevojitet një kërkim cilësor.

Viktimat (dhe organizatat e viktimave) mund ta përdorin internetin dhe median sociale për qëllime të ndryshme nga tregimi i dëshmimeve drejtpërdrejt për një audiencë, siç tregohet më poshtë:

- Për të krijuar një databazë faktesh historike;
- Për të qenë një »aktivist« online, d.m.th. një zë i besueshëm që kundërshton gjuhën e urrejtjes dhe radikalizmin online;
- Për të ndihmuar njerëzit që mbështesin rastin tuaj në shoqëri duke u vendosur në dispozicion një platformë, dhe për t'u siguruar informacion ndihmës për punën e tyre në terren. Për të mbështetur prindërit që dëshirojnë të diskutojnë tematika të caktuara me fëmijët e tyre, ose madje për të ngritur një shërbim ndihme.

»Harta e terrorit« nga »Collective of Victims of Terrorism« (COVITE) (Spanjë) përdor fuqinë e komunikimit online duke ofruar tekste, video dhe imazhe të vendeve në të cilat kanë ndodhur sulme. E gjithë përmbajtja përdoret, përmes instrumenteve multimediale, për të kontekstualizuar terrorizmin dhe për të shpjeguar sesi radikalizmi i dhunshëm mund të shkatërrojë jetë. Shih në internet: <http://mapadelterror.com/en>

Kapitulli 4: Bashkëpunimi me median

Sulmet terroriste kanë si qëllim kryesor ndikimin tek opinioni publik, sesa vetë viktimat. Media dhe terroristët kanë nevojë për njëri-tjetrin, kanë një marrëdhënie simbiotike mes tyre⁶. Terrorizmi synon t'i tregojë historitë e tij jo përmes këndvështrimit të viktimave, por përmes këndvështrimit të spektatorëve. Terrorizmi kërkon vëmendjen e spektatorëve, duke përhapur frikë dhe terror nga njëra anë dhe nëpërmjet propagandës konkrete për të rekrutuar nga ana tjetër, në një marrëdhënie simbiotike me median. Viktimat dhe shoqatat e tyre përpigën të përmbysin dhe kundërshtojnë një perspektivë të tillë duke përmirësuar këndvështrimin e tyre, që konsiston nga tregimet, dëshmitë, fjalimet publike dhe intervistat. Por, si mund ta përdorin organizatat e viktimave (dhe vetë viktimat) median për të bërë një kundër-komunikim me synimin për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin?

Një nga avantazhet e medias është fakti që ajo mund t'i drejtohet një audience më të gjerë. Disavantazhi është fakti që organizatat e viktimave humbasin kontrollin mbi mesazhin. Që të dyja palët (organizatat e viktimave dhe media) duhet të përfitojnë reciprokisht nga përhapja e mesazhit. Kjo do të nënkuptonte lajme të rëndësishme që janë në linjë me mesazhin e viktimave. Ky ndryshim në objektiva duhet të merret në konsideratë.

Në varësi të rrethanave, secila prej palëve mund t'i drejtohet tjetrës. Për rrjedhojë, pyetjet kryesore që lindin janë si më poshtë:

1. Si mund ta përdorin organizatat e viktimave (dhe viktimat) median në mënyrë aktive për të përhapur një mesazh specifik për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm? Kur është efektive diçka e tillë? Kur është në interes të medias?
2. Si duhet të reagojnë organizatat e viktimave (dhe viktimat) kur kontaktohen nga media (në mënyrë reaguese)? Kur është efektive diçka e tillë? Kur është në interesin e organizatës së viktimave?

⁶ Terrorism, Media, and the Ethics of Fiction, Antony Kubiak (2010).




Figura 1 Marrëdhënia mes organizatave të viktimave dhe medias

Kapitulli 4 përqendrohet në organizatat e viktimave që bashkëpunojnë me median, por vlen edhe për viktimat dhe organizatat e tjera që merren me parandalimin e radikalizimit dhe rolin e mediave. Shumica e mësimave të nxjerra janë të zbatueshme nga të dyja perspektivat e përshkruara më lart, qoftë kur kontaktojnë aktivisht me median apo si përgjigje ndaj kontaktimit nga kjo e fundit.

Ekziston një ndryshim ndërmjet përmbajtjes së një dëshmie në media dhe formës së dëshmisë. Forma është stili, kanali ose media e përdorur për të përcjellë një dëshmi. Përmbajtja i referohet temës. Përgatitja e të intervistuarit dhe gazetarit është gjithashtu shumë e rëndësishme. Folësi nga organizata e viktimave (i cili mund të jetë një viktimë) duhet të këshillohet, trajnohet dhe mbështetet nga organizata e viktimave ose nga një ekspert në lidhje me mënyrën e përbalimit të vëmendjes mediatike.

Për organizatat e viktimave nevojitet gjithashtu përgatitja në një shkallë më të gjerë, si p.sh. zhvillimi i një plani apo strategjie komunikimi. Është gjithashtu e rëndësishme vendosja dhe ruajtja e marrëdhënieve të mira mes organizatës dhe medias, pasi kjo mund të ndihmojë në përcjelljen e mesazhit.

4.1 Përmbajtja

Për të tërhequr vëmendjen e medias, një organizatë viktimash duhet ta bëjë historinë e saj interesante dhe të lehtë për t'u përpunuar nga gazetarët dhe redaktorët: të jetë e shkruar ose e thënë qartë, idetë të jenë të shprehura në mënyrë aktive dhe të përshtatshme, të jenë përkatëse dhe interesante. Media do ta vlerësojë historinë nga këndvështrime të reja. Për shembull, kjo mund të arrihet duke ftuar si folës persona të rëndësishëm. Kur angazhohet një person i rëndësishëm, duhet të sigurohet që ai do të përcjellë në mënyrë të besueshme mesazhin e duhur.

Një mënyrë tjetër e përfshirjes së medias është vënia në dukje e diçkaje të re: një dëshmi e re, një ngjarje, një koncept i ri, një qasje apo përvjetor. Për shembull, shfrytëzimi i momentit, përdorimi

i një dite përkujtimore të viktimave për të krijuar më shumë vëmendje dhe për të vënë në dukje çështje të rëndësishme, projekte etj. Për ta bërë historinë më të thellë, subjekti mund të vendoset në një kontekst më të gjerë politik ose të lidhet me një ngjarje të kohëve të fundit, duke theksuar se si historia/puna lidhet me këtë ngjarje, si dhe duke përdorur dëshmitë e viktimave që kanë një lidhje reale me një ngjarje të fundit terroriste.

Historitë »Davidi kundër Goliatit« janë të njohura. Një grup i vogël personash që luftojnë për drejtësi kundër një organi më të madh, qoftë ai shteti, sistemi i drejtësisë apo një lëvizje radikale ose ekstremiste pranohet gjerësisht. Në përgjithësi, përkujtimet nuk kërkohen shumë nga shtypi pasi ato priren të jenë vjetore dhe janë kryesisht jombresëlënëse. Mund të bëjnë përjashtim përvjetorët e rëndësishëm, si 5-vjetorët apo 10-vjetorët. Gjatë përpjekjes për ta bërë historinë më interesante, siç u përshkrua më lart, sigurohuni të ruani lidhjen me historinë personale. Mesazhi kryesor është historia e vërtetë individuale.

Më poshtë jepen disa këshilla sesi të zgjohet interesi i medias:

- Jini i sigurt për mesazhin tuaj (çfarë dëshironi të përcillni, arsyen e përcjelljes dhe përse zgjodhët këtë moment);
- Krijoni një rrëfim efektiv dhe të kuptueshëm; perfeksionojeni dhe besojeni atë;
- Mos u përpiqni të jepni shumë informacion, por fokusohuni në mesazhin kryesor. Shmangni kontradiktat dhe ngatërresat brenda rrëfimit;
- Jini koherentë dhe fokusohuni në elementet thelbësore të mesazhit;
- Shmangni paraqitjen si shumë jopersonal dhe institucional. Qëndroni autentik;
- Mos bëni pohime tepër të sigurta apo të përgjithësuara (për punën apo për grupin e përfaqësuar), sepse ato mund të mbeten për një kohë të gjatë te grupi apo organizata;
- Mos flisni për financime;
- Mos jini instrument apo vegël e gazetarit, politikës apo ideologjisë;
- Jini krijues në komunikimin tuaj.
- Përpiquni të vendosni personalisht kontakt me median

4.2 Forma

Forma është stili, kanali ose media e përdorur për një dëshmi. Në rastin e bashkëpunimit të organizatave të viktimave me median, këto të fundit mund të kenë pritshmëri të ndryshme lidhur me mënyrën sesi duhet të tregohet historia. Për shembull: perceptimi i kohëzgjatjes së mbulimit nga gazetarët dhe të intervistuarit shpesh është i ndryshëm. Gazetarët kanë gjasa të marrin në konsideratë një lajm 2-minutësh në televizion në vend të një përmbledhjeje më të gjatë, ndërsa viktima e cila dëshiron të tregojë të gjithë historinë e saj do e konsideronte atë si tepër të shkurtër. Të dyja palët duhet të jenë të qarta për pritshmëritë e tyre në mënyrë që të përmirësojnë bashkëpunimin dhe të shmangin zhgënjimin.

Më poshtë jepen disa këshilla në këtë drejtim.

- Një komunikatë e vetme për shtyp mund të mos jetë efektiv, duke qenë se shtypi merr shumë të tilla. Përdorimi i disa kanaleve të komunikimit (për shembull edhe i medias sociale) krijon përshtypjen e diçkaje shumë aktuale.
- Ndjekja pas komunikimit për shtyp, duke u telefonuar gazetarëve, mund të jetë e dobishme për ta vënë mesazhin më në dukje.
- Nxitini gazetarët që të citojnë emrin e organizatës së bashku me historinë e viktimës.
- Kur është e përshtatshme, botoni një artikull në rubrikën »opinion«, për të dhënë një mendim ekspert.
- Fitoni vëmendje mediatike duke ftuar personalitete të njohura dhe publike, zyrtarë, drejtues opinionistë, ambasadorë dhe folës prestigjiozë.
- Arkivoni të gjithë vëmendjen mediatike në një databazë me burim të hapur, e cila mund të përdoret nga organizata e viktimës, por edhe nga media të tjera.

»Project Papillon« nga »Association française des Victimes du Terrorisme« (AfVT) (Francë) mbledh së bashku një grup të rinjsh viktimë të terrorizmit të moshës 15 dhe 23 vjeç. Grupi mori pjesë në diskutime ditore në grup, të drejtuara nga psikologë dhe që përfshinin aktivitete sportive dhe rekreative.

Projekti u soll në mënyrë proaktive në vëmendjen e medias dhe u zgjodh nga media të ndryshme. Të gjithë artikujt e botuar për projektin u arkivuan dhe mund të gjenden në faqen e internetit.

Shih në internet: <http://www.afvt.org>

4.3 Përgatitja

Duke qenë një organizatë viktimash, përpara angazhimit me median nevojitet përgatitje e përgjithshme. Kjo nënkupton një plan dhe strategji komunikimi, duke përfshirë një politikë për shtypin, një grup rregullash praktike për mënyrën e bashkëpunimit me shtypin. Në këtë plan, përcaktoni qëllimet dhe objektivat e komunikimit, përshkruani rolin e organizatës së viktimave dhe, nëse është e mundur, përpiquni të jeni lidhja ndërmjet viktimave dhe medias. Si një organizatë viktimash, është e rëndësishme të njihni viktimat me të cilat punoni, me qëllim që të zgjidhni folësin e duhur që ka aftësinë më të mirë për të folur në media.

Për më tepër, organizatat e viktimave mund të mbështesin viktimat në marrëdhënien e tyre me median nëpërmjet këshillimit, si dhe të rrisin vetëvlerësimin e tyre. Megjithatë, mos lejoni që kjo të rezultojë në histori perfekte, jooriginale. Kur përgatisni viktimë për të folur në media, tregojuni atyre dy ose tre shembuj të projekteve apo programeve të organizatës suaj. Kjo e bën më të lehtë shpjegimin e veprimtarisë së organizatës. Pas tregimit të historisë në media, kontrolloni nëpër media sociale për të parë sesi është pritur historia nga publiku dhe për reagime.

Më poshtë jepen mësimet e tjera të nxjerra në lidhje me përgatitjen për vëmendje mediatike:

- Paramendoni se sa personale duhet të jetë historia. Gazetarët i adhurojnë historitë personale. Historitë nuk mund të tërhiqen pasi janë bërë publike.
- Përpara një interviste, merrni informacion për kanalën mediatik, cilësinë e tij, shkallën e mbulimit dhe programin, lajme të mëparshme të ngjashme dhe gazetarët e tij.
- Perfeksiononi çdo pjesë të mesazhit dhe përshtateni mesazhin sipas kërkesës së medias.
- Programet e prodhuara nxitimthi dhe me tematikë të gjerë kanë tendencën t'u japin gazetarëve një ide jo të qartë në lidhje me veprimtarinë e organizatës.

Viktimat dhe organizatat e viktimave duhet të jenë të vetëdijshme për ndikimin e ekspozimit mediatik te viktimat dhe familjet e tyre, si në termat afatshkurtër edhe në ato afatgjata. Media i nxjerr njerëzit nga jeta e tyre anonime. Produktet mediatike do të jenë të lehta për t'u gjurmuar gjatë një periudhe të gjatë dhe të ripërdoren tërësisht ose pjesërisht për transmetime dhe botime. Për të menaxhuar pasojat e bërjes personazh publik, viktimat duhet të mbështeten dhe këshillohen nga organizatat e viktimave.

4.4 Marrëdhëniet me median

Është jashtëzakonisht e rëndësishme një marrëdhënie e qëndrueshme me median. Në këto rrethana, ato mund të ofrojnë mbështetje të madhe për përhapjen e mesazhit dhe punën e organizatës së viktimave. Për të arritur këtë, investoni në marrëdhënie dhe paraqitni interes për median (siç përshkruhet në seksionin e përmbajtjes).

Rekomandimet e mëposhtme do të ndihmojnë në ruajtjen e një marrëdhënieje të qëndrueshme me median:

- Zgjidhni gazetarët dhe kanalet mediatike me të cilat do të punoni, duke u fokusuar tek ato që përbëjnë interes për vendosjen e një marrëdhënieje afatgjatë.
- Përpiguni të perceptoheni nga media si një aktor/ekspert specifik në fushën e viktimave të terrorizmit.
- Nxirrni një politikë shtypi dhe caktoni një folës për organizatën.
- Mbani kontakt me shtypin dhe arkivoni të gjithë artikujt mediatikë përkatës.
- Historitë ekskluzive mund të jenë efektive, pasi ato i vendosin gazetarët në një pozitë unike. Megjithatë, nga ana tjetër, kjo mund të shkaktojë edhe neglizhimin e historisë nga mediat e tjera. Ky rrezik mund të minimizohet duke mos ia dhënë ekskluzivitetin gjithmonë të njëjtit gazetar/medie. Është gjithashtu e rëndësishme të ruhet një pozicion neutral, publikimi vetëm në mediat e krahut të djathtë apo të majtë mund t'i veshë historisë suaj një anim të dukshëm politik.

Kapitulli 5: Bashkëpunimi me ish-ekstremistët

Bashkëpunimi mes viktimave të terrorizmit dhe ish-ekstremistëve mund të jetë efektiv për rritjen e ndërgjegjësimit mbi radikalizmin dhe për të ndihmuar në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Megjithatë, kjo nuk është zgjidhja e vetme për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Ky bashkëpunim është i një natyre të ndjeshme dhe ka disa parakushte që do të theksohen në këtë kapitull. Rreziqet duhet të minimizohen dhe, sigurisht, jo çdo ish-ekstremist do të jetë në gjendje të bashkëpunojë me viktimat dhe anasjelltas.

Bashkëpunimi me ish-ekstremistët mund të prodhojë një rrëfim të dobishëm vetëm nëse ata janë të deradikalizuar dhe janë në gjendje të shpjegojnë arsyet dhe mënyrën sesi e kuptuan që ekstremizmi i dhunshëm ishte mënyra e gabuar për arritjen e qëllimeve të tyre.

Një »ish-ekstremist« është një ish-aktivist radikal, një person që dikur ka pasur ide ose sjellje ekstremiste. Një »ish-ekstremist« është një person i deradikalizuar dhe/ose i tërhequr nga ai qëndrim.

Në fund, tërheqja nga ai qëndrim duhet të nënkuptojë ndryshime në sjellje, si kundërshtimin e dhunës (Horgan and Braddock, 2010).

Megjithatë, për të qenë i deradikalizuar duhet të ketë ndodhur gjithashtu një ndryshim më rrënjësor i idealeve që qëndrojnë në zemër të kësaj sjelljeje (Metzger, 2013; Ganor and Falk, 2013).

Ish-ekstremistët duhet të dënojnë aktet/idetë terroriste përpara se t'ia tregojnë historinë e tyre audiencës (pra, ato nuk duhet vetëm të tërhiqen, por edhe të deradikalizohen). Pjesëmarrja e ish-aktivistëve radikaliste në punën e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm duhet t'i ketë distancuar ata nga mendësia apo sjelljet ekstremiste, duke hequr dorë nga ndonjë grup i caktuar ose duke kundërshtuar dhunën që dikur e përdornin apo duke falur.

Në situata të caktuara, një faktor i mundshëm ndërlikues është fakti që edhe autorët mund ta konsiderojnë veten viktimë. Ndonjëherë, siç ndodh në luftërat civile, njerëzit mund të jenë në dy pozita njëkohësisht, në atë të viktimës dhe autorit. Për më tepër, autorët mund ta konsiderojnë veten viktimë të rrethanave të tyre (p.sh. për shkak të situatës së tyre social-ekonomike).

Në disa vende, ish-ekstremistët dhe viktimat bashkëpunojnë në projekte për ndërgjegjësimin mbi rreziqet e ekstremizmit të dhunshëm, si p.sh. në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë, ku drejtohen një sërë programesh të tilla. Megjithatë, në vende të tjera, një bashkëpunim i tillë konsiderohet tabu, qoftë mbi baza emocionale, politike apo etike.

Një shembull i punës me »ish-ekstremistët« është »West London Initiative«. Organizata operon në nivelin bazë dhe personeli i saj përbëhet si nga individë që vijnë nga prejardhje të ngjashme me audiencën e synuar, edhe nga specialistë të kualifikuar dhe me përvojë.

Kjo i mundëson organizatës të ofrojë një gamë të gjerë ndërhyrjesh, ngjarjesh, projektesh dhe seminaresh që kanë si qëllim edukimin, fuqizimin, ngritjen e kapaciteteve rikuperuese dhe nxitjen e pjesëmarrjes në shoqërinë civile. Një faktor i rëndësishëm është aftësia për të prekur të rinj, të cilët është e vështirë të arrihen nëpërmjet metodave të posaçme novatore të ndërhyrjes në nivelin bazë, të përshtatura sipas nevojave të çdo personi të përfshirë.

5.1 Fuqia e dy anëve të monedhës

Efikasiteti i bashkëpunimit ndërmjet ish-ekstremistëve dhe viktimave varet nga faktorë të ndryshëm dhe ndryshon nga një situatë tek tjetra. Avantazhi i këtij bashkëpunimi është fakti që audiencia dëgjon të dyja anët e historisë, gjë e cila lartëson rrëfimin/dëshminë, mesazhin dhe vetë kuptimin e mesazhit.

Përdorimi i të dyja historive mund të ndihmojë për të deheroizuar terroristët dhe ekstremizmin e dhunshëm (ndikimin e tij): për shembull, kur një ish-ekstremist diskuton për jetën në burg dhe viktima për humbjen e një personi të dashur. Po ashtu, dëshmitë mund të ndihmojnë audiencën që të kuptojë më mirë »personin tjetër« nëpërmjet këtyre historive personale. Ato theksojnë aspektin njerëzor dhe kundërshtojnë dehumanizimin e »personit tjetër«.

Dëshmitë e viktimave dhe ish-ekstremistëve mund të jenë gjithashtu një instrument ndërmjetësi (publik) dhe mund të ndihmojnë për të prishur ciklin e negativitetit, duke rregulluar marrëdhëniet e prishura dhe komunitetet. Në situata të caktuara, audiencia mund të kërkojë informacion nga ish-ekstremistët dhe në këtë rast ndikimi i ish-ekstremistëve mund të jetë më efektiv se historia e viktimës.

Për më tepër, viktima dhe ish-ekstremisti mund të mësojnë nga njëri-tjetri dhe nga historitë respektive - puna së bashku si viktima dhe autor është gjithashtu një akt vetëshërimi. Bashkëpunimi i tyre mund të shërbejë si shembull për viktimat dhe ish-ekstremistët e tjerë.

5.2 Kushtet paraprake për bashkëpunim

Përpara fillimit të një bashkëpunimi, është e nevojshme të bëhet dallimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm. Krahas viktimave dhe ish-ekstremistëve, përbëjnë interes edhe dëshmitë e të afërmeve të të dyja grupeve, si dhe dëshmitë e personave të cilët kanë qenë dikur në prag të kthimit në ekstremist, por janë tërhequr. Interesi i këtij grupi qëndron në pyetjet vijuese: cilat ishin arsyet që e ndalën në momentin e fundit, cilët ishin faktorët rikuperues dhe si mund të aktivizohen ata? Viktima mund të hasë më pak konfrontim dhe më pak vështirësi bashkëpunimi me të afërmit e ish-terroristëve.

Parakushtet për përdorimin e dëshmime zbatohen edhe për bashkëpunimin me viktimat dhe ish-ekstremistët. Bashkëpunimi duhet të jetë pjesë e një programi më të gjerë, viktimat dhe ish-ekstremistët duhet të jenë të mirëpërgatitur, të kenë mbështetje dhe të jenë mendërisht të gatshëm për t'u përfshirë, dhe audienca duhet të informohet dhe përgatitet paraprakisht dhe më pas t'i bëhet një prezantim i shkurtër.

Moderatori (mësuesi, trajnuesi, drejtuesi i diskutimit etj.) duhet ta diskutojë paraprakisht temën dhe kontekstin, të shpjegojë faktet historike, të menaxhojë pritshmëritë dhe të fuqizojë kapacitetet e të menduarit kritik dhe aftësinë rikuperuese. Gjithashtu, ata duhet ta drejtojnë diskutimin vijues në mënyrë të tillë që të maksimizojnë efektin pozitiv të dëshmimeve. Fakti nëse një ish-ekstremist dhe një viktimë janë gati të japin dëshminë e tyre varet nga individët dhe rrethanat. Për më tepër, viktimat dhe ish-ekstremistët duhet të bëjnë të qartë se cilat janë nevojat e tyre, çfarë mund të trajtojnë dhe me cilët do të bashkëpunojnë etj.

Kur dëshmitë e viktimave dhe ish-ekstremistëve përdoren në të njëjtin program/në të njëjtin rast, nuk është nevoja që ato të moderohen. Nuk ekziston një hierarki për dëshmitë dhe nuk duhet të ekzistojë perceptimi se njëra palë është »moralisht superiore« ndaj palës tjetër. Censurimi i një dëshmie do të kishte efekte negative. Dëshmitë nga viktimat dhe ish-ekstremistët duhet të lihen siç janë: ato janë histori personale dhe të dyja palët kanë të drejtë t'i tregojnë ato. Nëse një viktimë ose ish-ekstremist nuk është në gjendje të përballojë rrëfimin e historisë, nuk mund të ketë bashkëpunim. Përpara bashkëpunimit, është thelbësore që të dy personat të takohen, të njohin më mirë njëri-tjetrin dhe të përgatisin në detaj bashkëpunimin e tyre.

Ish-ekstremistët mund të jenë qendra e vëmendjes, duke qenë se dëshmitë e tyre janë veçanërisht tërheqëse për të rinjtë, si rezultat i elementit »aksion dhe aventurë« që shpesh konsiderohet tërheqës. Ish-ekstremistët kanë luftuar aktivisht për një qëllim specifik. Kjo mund të shkaktojë një figurë të heroizuar të personit dhe të ideologjisë ekstremiste. Të dyja palët duhet të jenë të vetëdijshme për këtë anësi dhe të përpiqen të ruajnë një vëmendje të ekuilibruar. Një alternativë është përfshirja e dëshmisë së ish-ekstremistit si pjesë më e vogël e programit.

Ish-ekstremistët nuk duhet të fokusohen vetëm tek arsyet e tyre personale e biografike për t'u bërë të radikalizuar (elementi »Pse«). Në radikalizimin e tyre mund të kenë kontribuar një sërë problemesh personale. Por arsyet personale e biografike nuk mund të përbëjnë një shpjegim të plotë e gjithëpërfshirës për kryerjen e akteve terroriste. Në vend të kësaj, ata duhet të shpjegojnë zgjedhjet dhe alternativat që kanë pasur, personat që kanë takuar etj. (elementi »si«, procesi). Duhet të disponohet një hartë e rrethanave kritike dhe ngjarjeve vendimtare që kanë çuar në aktin e dhunshëm.

Bashkëpunimi mund të realizohet në mënyra të ndryshme: dëshmi të drejtpërdrejta të prezantuara njëkohësisht në të njëjtin vend dhe përpara një audience, ose dëshmi të shkruara apo të regjistruara në film. Zgjedhja e medias varet nga qëllimi, situata, audienca dhe efekti i dëshiruar. Organizata që përdor dëshmitë duhet të jetë e vetëdijshme për kontekstin lokal dhe t'i përdorë ato dëshmi dhe kanale komunikimi sipas kontekstit lokal (përshtatja e tyre me rrethanat). Duhet të merren në konsideratë konteksti dhe nevojat e viktimës dhe ish-ekstremistit, pasi ato mund të ndikojnë në

mesazhin e tyre dhe të shkaktojnë vështirësi të caktuara. Është e rëndësishme të dihet specifikisht nëse viktima dhe ish-ekstremisti kanë ndarë të njëjtin sulm terrorist, të njëjtin konflikt apo të njëjtën formë të ekstremizmit të dhunshëm (ekstremizmi i djathtë apo i majtë, xhihadizmi...), me qëllim përgatitjen e ndërhyrjes së tyre.

Nevojiten në shumë hulumtime në lidhje me efektin e dëshmive të ish-ekstremistëve dhe viktimave dhe sigurisht për ndikimin dhe efektin e bashkëpunimit të tyre.

Translated within:

